



Buletini mujor

Mars 2026



Anketa e Buxhetit të Hapur - OBS 2025, KLSH vlerësohet ndër institucionet më efektive në rajon për mbikëqyrjen e financave publike

Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit (*International Budget Partnership - IBP*), ka publikuar në muajin mars 2026 rezultatet e "Anketës së Buxhetit të Hapur 2025" (Open Budget Survey – OBS) për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.

Raporti, i përgatitur me mbështetjen e Komisionit Evropian, vlerëson transparencën buxhetore, mbikëqyrjen legjislative dhe auditimin e pavarur, si dhe pjesëmarrjen publike për 7 vende në Ballkanin Perëndimor: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mali i Zi, Serbi, Kosovë, Maqedonia e Veriut dhe Turqi.

Në "Anketën e Buxhetit të Hapur 2025", Kontrolli i Lartë i Shtetit është renditur ndër institucionet me performancën më të mirë në rajon për mbikëqyrjen e financave publike, duke kontribuar që Shqipëria të ketë një nivel mbi mesatar për transparencën dhe kontrollin buxhetor.

Anketa analizon rolin e legjislaturave dhe institucioneve supreme të auditimit në mbikëqyrjen buxhetore, nga shqyrtimi i buxhetit deri te monitorimi i zbatimit dhe kontrolli i llogarive financiare.

Në rezultatet e anketës "OBS 2025", Shqipëria ka marrë 64 pikë nga 100 në fushën e transparencës buxhetore, duke reflektuar përmirësime në publikimin në kohë dhe gjithëpërfshirjen e dokumenteve buxhetore.

Në aspektin e mbikëqyrjes buxhetore, Shqipëria shënon një rezultat të përgjithshëm prej 69 pikësh duke u pozicionuar më mirë se shumica e vendeve fqinje, ndonëse jo në krye. KLSH është institucioni kryesor i auditimit publik në Shqipëri dhe një nga faktorët kyç në rezultatin e mirë të mbikëqyrjes.

Kuvendi vlerësohet me 64 pikë për mekanizmat e mbikëqyrjes, ndërsa Kontrolli i Lartë i Shtetit me 78 pikë, rezultat që reflekton një rol relativisht të fortë të KLSH-së në auditimin e financave publike.

Një nga dobësitë e evidentuara në raport për Shqipërinë është pjesëmarrja e ulët publike në procesin buxhetor, me vetëm 17 pikë nga 100, duke treguar nevojën për më shumë hapësira dhe mekanizma për përfshirjen e qytetarëve.

Në nivel rajonal, "OBS 2025" vëren se, pavarësisht përparimeve në praktikat formale të buxhetimit, mbeten sfida në forcimin e llogaridhënies dhe në zbatimin e rekomandimeve të auditimit, faktorë që ndikojnë drejtpërdrejt në besimin e publikut.

Raporti thekson rëndësinë e forcimit të mbikëqyrjes parlamentare gjatë zbatimit të buxhetit, rritjes së transparencës për ndryshimet brenda vitit buxhetor dhe krijimin e mekanizmave më efektive për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Kryetari i KLSH-së zhvillon takim pune me Auditoren e Përgjithshme të Kosovës, znj. Vlora Spanca

Në vijim të bashkëpunimit dhe auditimeve të përbashkëta mes dy institucioneve homologe të auditimit, në datë 3 mars 2026, Kryetari i Kontrollit Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, zhvilloi një takim pune me Auditoren e Përgjithshme të Kosovës, znj. Vlora Spanca në ambientet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Bisedimet gjatë takimit u përqendruan në auditimet e përbashkëta të kryera me sukses nga të dy institucionet, si dhe në tema auditimi të mundshme në të ardhmen, në bashkëpunim jo vetëm mes dy vendeve, por edhe vendeve të tjera të rajonit.

Gjatë takimit u theksua rëndësia e forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale, shkëmbimit të eksperiencave profesionale dhe praktikave më të mira në fushën e auditimit publik. Të dyja palët vlerësuan rezultatet e arritura deri më tani dhe shprehën angazhimin për thellimin e bashkëpunimit dhe realizimit të projekteve të reja me interes të ndërsjellë.



Institucionet Supreme të Auditimit të EUROSAT-t diskutojnë thellimin e bashkëpunimit në Pragë



Në datë 10 mars 2026, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në Konferencën e Nivelit të Lartë mbi Gjithëpërfshirjen, të mbajtur në Pragë. Ky takim mbledhi përfaqësues të institucioneve supreme të auditimit nga e gjithë Evropa për të diskutuar mënyrat e forcimit të bashkëpunimit brenda organizatës EUROSAT. Pjesëmarrësit e konferencës dyditore (10-11 mars) diskutuan se si të bashkëpunojnë brenda EUROSAT-t për auditim më efektiv, cilat janë temat përkatëse për auditimin dhe si të përdorin Inteligjencën Artificiale në auditime. Ata diskutuan gjithashtu nëse auditorët evropianë mund të identifikojnë shpejt sfidat e reja dhe pastaj t'u përgjigjen atyre së bashku përmes ndarjes së informacionit dhe njohurive. Në konferencë u fol edhe për sfidat me të cilat përballen institucionet e auditimit në vendet evropiane që nuk janë pjesë e BE-së.

"Përpara se të ndryshojmë mënyrën se si bashkëpunojmë, së pari duhet të kuptojmë se kush jemi (?), pikat tona të forta, kufizimet, dobësitë dhe potencialin tonë. Arsyeja pse jemi këtu sot është të dëgjojmë. Sepse bashkëpunimi nuk ndërtohet vetëm përmes dokumenteve, por përmes dialogut", tha Miloslav Kala, President i Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës Çeke (SAO), organizatore e konferencës.



Pjesëmarrja e KLSH-së në këtë konferencë dëshmoi angazhimin institucional jo vetëm në shkëmbimin e përvojave, por edhe në rritjen dhe përmirësimin e praktikave të përdorura gjatë proceseve audituese dhe menaxheriale. EUROSAT bashkon më shumë se pesëdhjetë institucione supreme auditimi nga e gjithë Evropa dhe është një nga forumet kryesore ndërkombëtare për bashkëpunim në auditimin e sektorit publik.



MOSHIMI I POPULLSISË

KLSH KRYEN AUDITIM PARALEL ME 5 INSTITUCIONE HOMOLOGE

“Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim”

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet homologe, zhvilloi auditimin e performancës me temë *“Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim”*.

Ky auditim vjen si rezultat i angazhimit që KLSH ka ndërmarrë me disa institucione homologe për të audituar fenomenin e moshimit të popullsisë, që ka prekur vendet e Evropës, por edhe më gjerë.

Në këtë auditim paralel, të drejtuar nga Zyra e Kontrollorit të Shtetit të Izraelit, u përfshinë Institucionet Supreme të Auditimit të Maqedonisë së Veriut, Sllovakisë, Portugalisë dhe Paraguait.

Auditimi kishte si objektiv kryesor vlerësimin e politikave, strategjive, planeve të vendit tonë që adresojnë çështjet, sfidat dhe problemet që lidhen me fenomenin e moshimit të popullsisë, për periudhën 2020-2025. Auditimi u zhvillua në institucionet që kanë përgjegjësi për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kombëtare për moshimin e popullsisë, konkretisht, në Ministrinë e Financave, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Institutin e Statistikave dhe në Shërbimin Social Shtetëror.


Popullsia e Shqipërisë po përballet me tkurrje të normave të rritjes natyrale, e cila vjen si rezultat i uljes së numrit të lindjeve dhe emigracionit të lartë.

Sipas Censurit 2023, popullsia banuese në Shqipëri në shtator 2023 ishte 2.402.113 banorë, duke shënuar një ulje prej rreth 420 mijë personash krahasuar me Censurin 2011. Ndërsa sipas të dhënave të INSTAT, popullsia e Shqipërisë në vitin 2023 ka qenë 2.761.785 banorë, me një ulje prej rreth 145 mijë persona, krahasuar me vitin 2011.

Të dhënat tregojnë se Shqipëria është në proces të një transformimi të thellë demografik, i karakterizuar nga rënie e vazhdueshme e lindshmërisë, emigrim i lartë i të rinjve në moshë pune, rritje e jetëgjatësisë dhe moshës mesatare të popullsisë.

Bazuar në të dhënat e Censurit 2023, popullsia në Shqipëri po kalon një proces të qartë moshimi, ku përqindja e personave mbi 65 vjeç ka arritur në 19.5% të totalit, nga 12.4% që ishte në vitin 2000, ndërsa pritet që kjo përqindje të rritet në mbi 30% brenda 20 viteve të ardhshme, duke krijuar presion të madh mbi sistemin shëndetësor dhe shërbimet sociale. Ky ndryshim reflekton uljen e lindshmërisë dhe rritjen e jetëgjatësisë mesatare, që tani është 77.3 vjet për meshkujt dhe 81.2 vjet për femrat. Po ashtu, INSTAT raporton se moshja mesatare e shqiptarëve ka arritur në 42.1 vjeç, duke reflektuar një trend të qartë të plakjes së popullsisë. Vetëm në 10-vjeçarin e fundit kemi një rënie të shtesës natyrore me afërsisht 88.3%, nga 10297 në vitin 2015, në 1208 në vitin 2024.

Shtesa natyrore e popullsisë për periudhën 1990-2025



“Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim”


Emigracioni masiv dhe ulja e lindshmërisë, sipas Censurit 2023, janë faktorët kryesorë të tkurrjes demografike. Gjatë viteve 2001-2011, rreth 500 mijë qytetarë emigruan nga vendi, me një mesatare prej 50 mijë personash në vit, trend ky që ka vijuar në mënyrë të ngjashme edhe më pas.

Gjatë periudhës 2011-2025 moshja mesatare në Shqipëri ka shënuar një rritje, nga rreth 32.6 vjeç në vitin 2011 në 38.8 vjeç në vitin 2023 dhe me një rritje akoma edhe më të shpejtë në vitet 2024 dhe 2025, respektivisht 43.5 dhe 44.3 vjeç. Ky trend reflekton kombinimin e fertilitetit të ulët, emigracionit të konsiderueshëm të rinjve, përmirësimit të shëndetit dhe rritjes së jetëgjatësisë. Këta faktorë ndikojnë në uljen e popullsisë së re dhe në rritjen e peshës së grupeve të moshës së mesme apo të të moshuarve.


Të dhënat tregojnë se norma e lindshmërisë në Shqipëri ishte 1.71 fëmijë për grua në vitin 2012 dhe në vitin 2023 zbriti në 1.21 fëmijë, ndërsa norma e BE-së ishte 1.38 lindje për grua në vitin 2023. Të dhënat demografike të marra nga INSTAT dhe të përpunuara nga grupi i auditimit tregojnë se në vitin 2024 është regjistruar numri më i ulët i lindjeve duke filluar që nga viti 1990. Konkretisht, në vitin 2024 në vendin tonë janë regjistruar rreth 23 310 lindje, duke vijuar një trend rënës prej disa vitesh.

Shtesa natyrore e popullsisë ka ardhur duke u ulur dhe, për 6-mujorin e parë të vitit 2025 kemi shtesë natyrore negative (- 835).

Konstatohet se, në tremujorin e parë të vitit 2025, lindjet shënuan rënie me 14,1%, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2024, ndërsa në tremujorin e dytë të vitit 2025 është shënuar një rënie me 7,4 %, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2024. Treguesi për të ardhurat dhe nivelin e jetesës tregon se familjet me fëmijë në varësi në vitin 2024, rrezikun për të qenë i varfër e kanë në masën 24.8%, ndërsa familjet pa fëmijë në varësi e kanë këtë rrezik në masën 10.5%. Gjithashtu, konstatohet se politika e “bonusit të bebes” për mbështetjen financiare të familjeve të reja, nuk ka ndikuar në rritjen e numrit të lindjeve në Shqipëri. Si rezultat, vendi ynë duhet të vlerësojë me prioritet ndryshimin e skemës së mbështetjes financiare për familjet me fëmijë.



Numri i lindjeve dhe vdekjeve për periudhën 1990-2025



LINDJET DHE EMIGRIMI

23 310



8541



200 741

Lindje janë regjistruar në vendin tonë në vitin 2024. Të dhënat demografike të marra nga INSTAT dhe të përpunuara nga grupi i auditimit tregojnë se në vitin 2024 është regjistruar numri më i ulët i lindjeve duke filluar që nga viti 1990.

Shtetas shqiptarë kanë paraqitur kërkesë për azil gjatë vitit 2024, kryesisht në vendet evropiane, ku destinacioni kryesor mbetet Mbretëria e Bashkuar, e ndjekur nga Italia, Franca dhe Gjermania.

Shtetas shqiptarë janë pajisur për herë të parë me leje qëndrimi në vendet evropiane, në total sipas viteve:

- 2019 – 30482 leje
- 2020 – 38299 leje
- 2021 – 55393 leje
- 2022 – 76567 leje

Mesazhi i auditimit

Nga ky auditim ka rezultuar se Shqipëria nuk ka një plan gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial që trajton fenomenin e moshimit të popullsisë. Ky fenomen adresohet në strategji apo plane sektoriale të cilat në vetvete nuk ofrojnë një mbështetje të plotë, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për çështjet e moshimit të popullsisë.

Politikat sektoriale të ndërmarra deri më tani nga institucionet përgjegjëse në tërësinë e tyre, nuk kanë sjellë ndikim në përmirësimin e treguesve, pasi vendi ynë vijon të ketë rënie të lindshmërisë me afërsisht 72% nga viti 1990 në vitin 2024, bilanc migrator negativ me migrim neto nga -15,030 persona në vitin 2018, në -32,497 në vitin 2022, si dhe rritje të moshës mesatare nga 32.6 vjeç në vitin 2011 në 44.3 vjeç në vitin 2025.

Duke iu referuar treguesve të analizuar është e nevojshme që të hartohen dhe të zbatohen politika të drejtpërdrejta në perspektivë afatgjatë, duke pranuar se ndryshimet në politikat e punësimit, lindshmërisë, migracionit, mbrojtjes sociale dhe zhvillimit ekonomik duan dekada që të kenë një efekt të qëndrueshëm në shoqëri.

Presidenca e EUROSAT-t publikon auditimin paralel mbi “Inteligjencën Artificiale” të udhëhequr nga Izraeli, pjesëmarrëse mes 12 SAI-ve edhe KLSH

Presidenca e EUROSAT-t ka publikuar raportin e konsoliduar të auditimit paralel mbi “Inteligjencën Artificiale”, i cili shqyrton përgatitjet e qeverive për zbatimin e IA-së. I udhëhequr nga Zyra e Kontrollorit të Shtetit të Izraelit (SAI i Izraelit), ky auditim paralel shumëkombësh bashkoi 12 SAI (Shqipëria, Estonia, Franca, Izraeli, Italia, Letonia, Lituania, Maqedonia e Veriut, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Zvicra).

Inteligjenca Artificiale (AI) nuk është më një çështje e së ardhmes në nivel politikash. Ajo tashmë po transformon mënyrën se si funksionojnë qeveritë, si ofrohen shërbimet publike dhe si fitohet ose humbet besimi i publikut. Në këtë kuptim, AI përfaqëson një ndryshim të thellë jo vetëm teknologjik, por edhe institucional dhe shoqëror.

Ky auditim paralel tregon se shumë vende po kalojnë me shpejtësi nga ambicia strategjike drejt zbatimit konkret. Megjithatë, niveli i gatishmërisë mbetet i pabarabartë. Progresi përshpejtohet aty ku strategjia, financimi, qeverisja, të dhënat, aftësitë dhe mekanizmat e kontrollit zhvillohen në mënyrë të koordinuar dhe të integruar; përkundrazi, ai ngadalësohet në rastet kur këta elementë zhvillohen të fragmentuar dhe të shkëputur nga njëri-tjetri. Auditimi i kryer gjatë periudhës maj 2024 - dhjetor 2025 përdori një kornizë të përbashkët analitike prej 9 temash dhe më shumë se 92 pyetjesh të strukturuar për të krahasuar përgatitjen kombëtare në të gjitha dimensionet strategjike, infrastrukturore dhe të zbatimit. Në mënyrë të përmblodhur, gjetjet kryesore nga auditimi sipas fushave paraqiten në vijim.

Plani Strategjik Kombëtar

Auditimi konstatoi se vendet po ndjekin qasje të ndryshme në zhvillimin e politikave për Inteligjencën Artificiale. Disa prej tyre kanë strategji kombëtare për AI të miratuara nga qeveria, ndërsa të tjera mbështeten në strategji më të gjera të transformimit digjital, iniciativa të veçuara, ose strategji në fazë drafti pa miratim formal. Në rastet kur përgjegjësia për qeverisjen është e përcaktuar qartë dhe koordinimi ndërministror funksionon në mënyrë efektive, strategjitë përkthehen më lehtë në veprime konkrete dhe në masa që forcojnë besimin e publikut. Këto masa përfshijnë edhe një theks të veçantë në rritjen e ndërgjegjësimit publik. Kapitulli arrin në përfundimin se drejtimi strategjik është më efektiv kur shoqërohet me përgjegjësi të qarta për zbatim dhe me objektiva të matshëm. Në këtë kuadër, rekomandohet rishikimi periodik i strategjive, për të siguruar që modeli i zgjedhur vazhdon të mbështesë një qasje të integruar në nivel ekosistemi, koordinim real ndërinstytucional dhe një zbatim të qëndrueshëm të politikave.

Buxhetet Kombëtare për Inteligjencën Artificiale

Financimi përbën një provë vendimtare të seriozitetit në zhvillimin e Inteligjencës Artificiale, dhe auditimi konstatoi se shumë vende ende përballen me mungesë transparence në këtë drejtim. Më pak se gjysma e vendeve raportuan një buxhet të qartë dhe të dedikuar për AI, ndërsa të tjerat e përfshijnë financimin për AI brenda buxheteve më të gjera digjitale ose sektoriale, duke e bërë më të vështirë vlerësimin nëse burimet përputhen me prioritetet strategjike. Kapitulli arrin në përfundimin se fragmentimi i buxhetimit dobëson mekanizmat e mbikëqyrjes dhe ngadalëson zgjerimin e qëndrueshëm dhe të koordinuar të iniciativave për AI. Në këtë kuadër, rekomandohet rritja e transparencës përmes dallimit të qartë ndërmjet financimit të drejtpërdrejtë për projekte të AI dhe investimeve mbështetëse (veçanërisht në infrastrukturë), konsolidimi i pasqyrimit të shpenzimeve në të gjitha ministritë, si dhe koordinimi i burimeve të jashtme të financimit përmes përcaktimit të përgjegjësive të qarta dhe planifikimit shumëvjeçar.

Udhëzimet Rregullatore

Gatishmëria rregullatore për AI është në zhvillim, por jo në mënyrë të njëtrajtshme. Rreth gjysma e vendeve raportuan se kanë publikuar udhëzime për AI, megjithëse të gjitha deklaruan ekzistencën e një institucioni të dedikuar përgjegjës për mbikëqyrjen. Akti i Inteligjencës Artificiale i Bashkimit Evropian po vepron tashmë si një katalizator i fuqishëm, megjithatë vendet parashikojnë kërkesa të larta për zbatim dhe kufizime në kapacitetet institucionale.



Kapitulli arrin në përfundimin se përgjegjësia institucionale është më e avancuar sesa udhëzimet operative, ndërsa aspektet etike shpesh mbeten në nivel parimor, pa mekanizma të qëndrueshëm dhe të verifikueshëm zbatimi.

Në këtë kuadër, rekomandohet publikimi i udhëzimeve praktike dhe të zbatueshme, trajtimi i përgatitjes për Aktin AI të BE-së si një proces gjithëpërfshirës në nivel qeveritar (jo vetëm si transpozim ligjor), si dhe forcimi i mekanizmave të detyrueshëm, duke përfshirë përcaktimin e qartë të përgjegjësive, gjurmueshmërinë e proceseve dhe kontrollin paraprak përpara vendosjes në përdorim, aty ku është e përshatshme.

Infrastruktura për Inteligjencën Artificiale

Shumë vende po investojnë në infrastrukturën për Inteligjencën Artificiale, veçanërisht në kapacitetet përpunuese, por zbatimi mbetet ende në zhvillim dhe krahasueshmëria ndërmjet vendeve kufizohet nga matje jo të njëtrajtshme. Mjediset kombëtare “cloud” janë të përhapura, megjithatë të gjitha vendet mbështeten edhe në ofrues të palëve të treta, duke konfirmuar se modelet hibride të ofrimit janë tashmë standard. Kapitulli arrin në përfundimin se infrastruktura përbën bazën mbi të cilën ndërtohen të gjitha zhvillimet e tjera, por ajo mund të shndërrohet edhe në një pengesë, nëse qeverisja, parashikimi i kërkesës dhe përgjegjësia në mjediset hibride nuk janë të qarta. Në këtë kuadër, rekomandohet hartëzimi i kapaciteteve ekzistuese dhe parashikimi i kërkesës, duke përfshirë si burimet kombëtare, ashtu edhe ato të kontraktuara, si dhe forcimi i qeverisjes në modelet hibride për të menaxhuar rreziqet që lidhen me sigurinë, kostot, qëndrueshmërinë dhe përqendrimin te furnitorët.



Auditimi paralel mbi “Inteligjencën Artificiale”

Siguria e Informacionit

Auditimi evidentoi një nivel të lartë ndërgjegjësimi mbi rreziqet e sigurisë që lidhen me Inteligjencën Artificiale, veçanërisht në lidhje me rrjedhjen e të dhënave dhe aksesin e paautorizuar. Megjithatë, bazat për zbatimin e detyrueshëm të praktikave të sigurisë rezultojnë më të dobëta. Protokollet e detyrueshme të sigurisë kibernetike dhe politikave specifike të privatësisë për AI nuk raportohen në mënyrë të qëndrueshme, ndërsa përvoja në menaxhimin e incidenteve mbetet e kufizuar, çka e bën edhe më të rëndësishme fokusin në parandalim dhe përgatitje. Kapitulli arrin në përfundimin se siguria e AI nuk është vetëm një çështje teknike, por një sfidë e mirëfilltë e qeverisjes.

Në këtë kuadër, rekomandohet vendosja e kërkesave bazë të detyrueshme dhe trajnimi i stafit sipas roleve, përmirësimi i gjurmueshmërisë dhe dokumentimit të proceseve, si dhe adoptimi i praktikave të sigurisë gjatë gjithë ciklit të jetës së sistemeve, të cilat të zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha ministritë dhe tek ofruesit e shërbimeve.

Niveli i Pjekurisë Digjitale

Bazat e të dhënave mbeten një kufizim vendimtar për zhvillimin e Inteligjencës Artificiale në shkallë të gjerë. Ndërsa të gjitha vendet raportuan ekzistencën e politikave për ndarjen e të dhënave, pengesat në nivel operacional vazhdojnë të jenë të pranishme, veçanërisht në formën e kufizimeve rregullatore dhe të qeverisjes, mungesës së ndërveprueshmërisë dhe niveleve të pabarabarta të gatishmërisë së të dhënave. Vlerësimet krahasuese ndërkombëtare konfirmojnë një model të përsëritur: politikave dhe platformat zhvillohen më shpejt sesa ndikimi i provuar në praktikë. Kapitulli arrin në përfundimin se qeveritë shpesh disponojnë “rregulla për ndarjen e të dhënave”, por jo gjithmonë kushtet operative për t'i ndarë ato në mënyrë efikase, të sigurtë dhe në shkallë të gjerë. Në këtë kuadër, rekomandohet forcimi i qartësisë së qeverisjes, thjeshtimi i proceseve, përmirësimi i ndërveprueshmërisë dhe cilësisë së të dhënave, si dhe ndërtimi i mekanizmave të auditueshmërisë, në mënyrë që ripërdorimi i ligjshëm i të dhënave të mund të demonstronhet në praktikë dhe jo vetëm të deklarohet.

Projektet Qeveritare

Inteligjenca Artificiale po prodhon raste konkrete përdorimi në sektorin publik, veçanërisht në fusha operative me volum të lartë, dhe shumë vende raportojnë përmirësime në produktivitet. Megjithatë, mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit nuk janë të integruar në mënyrë të qëndrueshme, ndërsa treguesit e performancës (KPI) shpesh përqendrohen kryesisht në efikasitet, duke lënë në hije dimensione të tjera të rëndësishme si cilësia e shërbimit, performanca e modeleve, qëndrueshmëria, ripërdorimi dhe menaxhimi i rreziqeve. Kapitulli arrin në përfundimin se zbatimi i AI po përparon më shpejt sesa aftësia e qeverive për të matur dhe krahasuar ndikimin e tij në mënyrë të besueshme. Në këtë kuadër, rekomandohet krijimi i një pasqyrimi të plotë dhe të unifikuar të portofolit të projekteve, adoptimi i kornizave të balancuara të vlerësimit dhe standardizimi i kërkesave minimale të raportimit, në mënyrë që vendimmarrja për zgjerimin e projekteve të bazohet në evidencë dhe rreziqet të mbeten të dukshme.

RREZIQET E SIGURISË TË LIDHURA ME IA

86% ➔ Rrjedhje të dhënash dhe qasje e paautorizuar



57% ➔ Dobësitë e qeverisjes dhe llogaridhënies



57% ➔ Sulmet kibernetike dhe komprometimi i sistemit



57% ➔ Transparenca dhe shpjegueshmëria



43% ➔ Sulmet e integritetit: manipulimi i të dhënave dhe ndryshimi i rezultateve



29% ➔ Dobësitë në mjedisin cloud dhe hibrid




Kapitali Njerëzor

Kapacitetet njerëzore përbëjnë kufizimin më të përhapur. Çdo vend raportoi mungesë ekspertësh në fushën e Inteligjencës Artificiale, ndërsa shumë prej tyre evidentuan gjithashtu mungesë studiuesish. Proceset e zhvillimit të aftësive (*upskilling*) janë në zhvillim në shumë vende, por nuk janë ende të përhapura në mënyrë të njëtrajtshme. Ndërkohë, mbajtja e roleve kyçe të drejtimit dhe mbikëqyrjes mbetet një dobësi, e cila mund të rrisë varësinë nga ofruesit e jashtëm. Kapitulli arrin në përfundimin se gatishmëria për Inteligjencën Artificiale varet kryesisht nga njerëzit dhe jo vetëm nga teknologjia. Në këtë kuadër, rekomandohet zhvillimi i strategjive të integruara të fuqisë punëtore, të cilat të kombinojnë zhvillimin e kapaciteteve arsimore, trajnimin sipas roleve, krijimin e strukturave mbështetëse (si qendrat e ekspertizës dhe mekanizmat e shkëmbimit të njohurive), si dhe forcimin e politikave të rekrutimit dhe mbajtjes së stafit për rolet kyçe të mbikëqyrjes dhe zbatimit.


Përpunimi i Gjuhës Natyrore / (Natural Language Processing)

Shumica e vendeve po zhvillojnë kapacitete për përpunimin e gjuhës natyrore (*Natural Language Processing - NLP*) në gjuhët vendase, megjithatë modeli dominues i ofrimit mbetet ai i jashtëm ose hibrid. Kjo situatë ngre çështje të rëndësishme në lidhje me varësinë afatgjatë dhe qeverisjen gjatë gjithë ciklit të jetës së sistemeve. Kapitulli arrin në përfundimin se kapacitetet gjuhësore përbëjnë një bazë thelbësore për zhvillimin e Inteligjencës Artificiale në shkallë të gjerë, si në ofrimin e shërbimeve publike ashtu edhe në operacionet e brendshme institucionale. Megjithatë, këto kapacitete duhet të jenë të qëndrueshme dhe të qeverisura në mënyrë efektive në kohë. Në këtë kuadër, rekomandohet trajtimi i NLP-së si një kapacitet i përbashkët dhe i ripërdorshëm, ndërsa në rastet kur ofruesit e jashtëm kanë rol qendror, duhet të përcaktohen qartë përgjegjësitë për mirëmbajtjen, monitorimin, dokumentimin, përditësimet dhe menaxhimin e rreziqeve.


Pengesat kryesore në promovimin e Inteligjencës Artificiale në sektorin publik




Kapitali Njerëzor dhe Mungesa e Aftësive




Infrastruktura dhe Kapaciteti Teknologjik




Kufizime Financiare dhe Buxhetore



Qeverisja, Koordinimi dhe Sfidat



Boshllëqe Ligjore dhe Rregullatore



Besimi, Ndërgjegjësimi dhe Rezistenca Kulturore

Përmbillet me sukses programi 1-vjeçar i trajnimit për auditimin e performancës nga SAI i Suedisë

Nga data 23 deri më 27 mars 2026, u mbajt në Stokholm billoku përmbillës i programit të trajnimit njëvjeçar të certifikuar për auditimin e performancës.

Cikli njëvjeçar i trajnimit për auditimin e performancës është zhvilluar dhe mbështetur nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (SNAO) në kuadër të Grupit të Përbashkët Punës për Aktivitetet e Auditimit për vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Programi ka përfshirë gjashtë module dhe shërbeu si platformë për zhvillim profesional dhe forcim të kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit në fushën e auditimit të performancës.

Në këtë program të rëndësishëm profesional, nga KLSH morën pjesë auditueset: Annavanessa Hoxhaj, Arjeta Çoku dhe Lorena Liçi, të cilat gjatë vitit të kaluar kanë punuar për realizimin e auditimit të performancës me temë "Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit".


Pas përfundimit me sukses të programit, Auditorja e Përgjithshme e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, znj. Christina Gellerbrant Hagberg, u ndau pjesëmarrësve certifikatat, duke konfirmuar njohuritë dhe aftësitë e fituara.

Duke vlerësuar përkushtimin dhe arritjet e audituesve të rinj, falë ndjekjes së programit njëvjeçar të trajnimit, Auditorja e Përgjithshme e Suedisë, theksoi rëndësinë e zhvillimit të kapaciteteve për auditimin e performancës në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Pjesëmarrja në këtë program dëshmon gatishmërinë e audituesve për të punuar sipas kriterëve evropiane, si dhe investimin e vazhdueshëm të institucionit në përmirësimin e njohurive dhe aftësive të punonjësve në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të auditimit.



KLSH i bashkohet nismës për dhurimin e gjakut



Në kuadër të fushatës kombëtare për dhurimin vullnetar të gjakut, punonjës të Kontrollit të Lartë të Shtetit iu bashkuan kësaj nisme humane, duke kontribuar në këtë akt që shpëton jetë. Më 05.03.2026, në ambientet e KLSH-së u zhvillua një seancë dhurimi vullnetar gjaku, në bashkëpunim me personelin mjekësor të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

KLSH ka kontribuar vazhdimisht në këtë fushatë, duke mbështetur pacientët me talasemi, të sëmurët kronikë, pacientët hemofilikë, ata që trajtohen me dializë, si dhe personat e aksidentuar.








Duke vlerësuar solidaritetin e Kontrollit të Lartë të Shtetit me këtë nismë, personeli i Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut falënderoi punonjësit e KLSH-së, të cilët tashmë e kanë kthyer në traditë dhurimin vullnetar të gjakut në ndihmë të pacientëve në nevojë. Vëmendja ndaj qytetarëve, veçanërisht ndaj personave në nevojë, është një nga prioritetet kryesore të punës së KLSH-së, edhe në veprimtarinë audituese, përmes rekomandimeve drejtuar institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave që sigurojnë shërbime cilësore dhe efikase.

I përkushtuar ndaj misionit për mbrojtjen e interesit publik, Kontrolli i Lartë i Shtetit kontribuon përmes auditimit të pavarur në forcimin e përgjegjshmërisë institucionale dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

Falënderit për leximin!



Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit
 E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 klsh_org_al
 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00